



NJOFTIM PËR KONTRATË

(Furnizim)

Procedurë e hapur

Në përputhje me Nenin 6 të "Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës"
(shtator 2021)

Data: 03.07.2024

Nr. i Prokurimit: BQK 24 041 121

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni:	038 222 055/452

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Furnizim me kafë përmes aparateve automatike"
Informacione të marrëveshje afatgjatë: Kontratë dy vjeçare, me mundësi vazhdimi në përputhje me nenin 36 të Rregullës së prokurimit në BQK.
Vlera e parashikuar vjetore e kontratës: 36,000.00 euro, me fjalë (tri/dhjetë/e/gjashtë/mijë/euro).
Ndarja në Pjesë: JO

III INFORMACIONE PËR FURNIZIMIN

Kompania e cila do të përzgjidhet për të realizuar këtë kontratë do të bëjë furnizimet - sipas specifikave teknike dhe funksionale të parapara në Dosjen e Tenderit.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/ KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me aplikacionet e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:	
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 në rast se aplikohet)) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!	<p><u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p><u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin 2 të dosjes së tenderit.</p>
	<p><u>Kërkesa 2:</u> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”.</p> <p><u>Evidenca 2:</u> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.</p>
	<p><u>Kërkesa 3:</u> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium).</p> <p><u>Evidenca 3:</u> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i ofertuesve, nga grupi kërkohet që së bashku me tenderin të dorëzojnë edhe marrëveshjen e nënshkruar në origjinal për krijimin e grupit. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm para ofertuesit për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i ipet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Në marrëveshjen e grupit kërkohet të specifikohet lideri i grupit..</p>
Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime	<p><u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Evidenca 4:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Kërkesa 5:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><u>Evidenca 5:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><u>Kërkesa 6:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><u>Evidenca 6:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 7 deri 10) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime.	<p><u>Kërkesa 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy (2) kontrata të natyrës se ngjashme gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë).</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi: a) certifikatat përkatëse ose referencat që evidentojnë realizimin e furnizimit të tillë dhe b) kopjet e kontratave përkatëse.</p> <p><u>Kërkesa 8:</u> Ofertuesi duhet të plotësojë formularin standard për kontratat që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><u>Evidenca 8:</u> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me furnizimet e realizuara në tri vitet e fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë edhe 2024 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë) duke saktësuar furnizimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej furnizimeve.</p> <p><u>Kërkesa 9:</u> Certifikatë ose licencë për cilësinë e produktit.</p> <p><u>Evidenca 9:</u> Ofertuesi duhet të dorëzojë certifikatën ose licencën për cilësinë e produktit.</p> <p><u>Kërkesa 10:</u> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Katalogët-, detaje të artikujve të ofruar për cilësinë e tyre si dhe katalogun për aparatet automatike që do të vendosen në hapësirat e BQK-së, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikat teknike.</p> <p><u>Evidenca 10:</u> Kataloget e të gjithë artikujve, të kenë të shënuar qartë produktin e ofruar, si dhe katalogun për aparatet automatike.</p>
Inspektimii kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale	Banka Qendrore mund të dëshirojë, me shpenzimet e tij, të kryej një inspektim të operatorëve ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapaciteteve disponuese vërtetimin e cilësisë, mjetet për transport, dhe çdo informatë tjetër që është të nevojshme që mund të dëshmojë që ofertuesi mund të realizoj kontratën.

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: E hapur

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: *“Tenderi i përshtatshëm me çmimin me të ulët”*

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit : afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit
10.07.2024, ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 10.07.2024, ora 14:00
Dokumentet me pagesë: Jo
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 1,500.00 € (një/mijë/e/pesëqind/euro) me vlefshmëri prej 90 ditësh, (dorëzohet me ofertë).
Kushti i sigurimi të kontratës: 10% e vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 24 muajsh.
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e hapjes
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave : 12.07.2024, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave: 12.07.2024, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr.“Garibaldi” nr.33, Prishtinë.

VIII ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)”, respektivisht sipas Neni 41 të këtyre Rregullave, “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.

IX ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimeve	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni:	038 222 055/452